



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË**

---

Numri i lëndës: 2020:050925

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396122

**C.nr.127/20**

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË**- Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Jashar Gashi, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit N. D., nga Klina, kundër të paditurëve A. K. dhe K. K. të dytë nga Peja, të paditurin e parë e përfaqëson avokatja Qëndresa Lajqi-Bajraktari nga Ferizaji - me bazë juridike pagimi i të ardhurave personale, vlera e kontestit 16.000 euro, në seancën e datës 29.02.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit N. D. nga Klina, kundër të paditurëve A. K. dhe K. K. nga Peja, me bazë juridike pagesa e të ardhurave personale, vlera e kontestit 16,000 euro.

II.**SECILA** palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi pranë kësaj gjykate, me 06.02.2004, ka parashtruar padi kundër të paditurëve A. dhe K. K. nga Peja, me bazë juridike pagesa e të ardhurave personale, vlera e kontestit 16,000 Euro.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka caktuar shqyrtimin kryesor për datën 29.02.2024, me fillim në ora 14:30h, dhe ka konstatuar, mungesën të palës paditëse dhe i autorizuari i tije av.Xhafer Maloku i cili ka qenë i njoftuar me ftesë të rregullte përmes dorëzuesit të Gjykatës për datën e shqyrtimit gjyqësor, dhe i njëjti edhe pse e ka pranuar ftesën ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi i të paditurit të parë avokatja Qëndresa Lajqi-Bajraktari ka prezentuar dhe është deklaruar se nuk kanë interes që të vazhdohet kjo procedurë dhe ka kërkuar që kjo padi të konsiderohet e tërhequr.

Me dispozitën e nenit : 423.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht është theksuar se : “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”. Meqenëse në seanca nuk ka prezantuar paditësi gjykata konsideroj se janë plotësuar kushte ligjore në kuptim të dispozitave të nenit, 423.3 të LPK-së, që padia e paditësit të trajtohet si e tërhequr, duke vendosur si ne pikën I të dispozitivit.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitiv të këtij aktvendimi lidhur me shpenzimet e procedurës në kuptim të nenit 450 të LPK- së.

Nga arsyet e lartcekura në kuptim të dispozitave të nenit: 423 para. 1 dhe 2 e lidhur me nenin 387 para. 1 pika c), dhe nenit 450 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË- DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL, C.nr. 127/20, 29.02.2024**

**Gj y q t a r i**

**Jashar Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.